

# Plani i Përvetësimit të Tokës

## Kllokot-Gjilan

Kosovë: Projekti i Rrugëve Rajonale – Mbështetja e Njesisë për Implementimin e Projektit (NjIP)

---

Klienti

**Ministria e Infrastrukturës**

---

Titulli i dokumentit

**Plani i Përvetësimit të Tokës: Rruga Kllokot - Gjilan**

---

Data e dokumentit

10.05.2019

Rishikimi: 5



iC consulenten Ziviltechniker GesmbH  
SchönbrunnerStrasse 297, 1120 Vienna, Austria  
T +43 1 521 69-0, F +43 1 521 69-180  
office@ic-group.org, www.ic-group.org  
FN 137252 t

EN ISO 9001

**FLETA KONTROLLUESE E DOKUMENTIT**

<b>NUMRI I PROJEKTIT:</b>	Numri i projektit 46x16285
<b>PËRGATITUR NGA:</b>	<b>iC consulenten Ziviltechniker GesmbH</b> Schönbrunner Strasse 297, A-1120 Vjenë Tel: +43 1 521 69 0 Fax: +43 1 521 69 180 E-Mail: office@ic-group.org
<b>PËRGATITUR PËR:</b>	<b>Ministrinë e Infrastrukturës</b> Adresa: Ndërtesa e Odës Ekonomike, Kati i Parë, Zyra nr. 2, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës Tel.: +381 (0) 38 200 28 610 E-Mail 1: mi.info@rks-gov.net; E-Mail 2: Qamil.Feka@rks-gov.net E-Mail 3: Valdete.a.mustafa@rks-gov.net
<b>DATA:</b>	10.05.2019
<b>REDAKTOR:</b>	Fejzić, Jacimovska, Vaso, Mathews

Data	Nr. i rishikimit	Redaktor	Kontrolluar nga	Aprovuar nga	Nënshkrimi
2017-11-02	0	Fejzić	Mathews	Useini	
2017-11-24	1	Fejzić	Mathews	Useini	
2018-01-31	2	Jacimovska	Mathews	Useini	
2018-03-15	3	Jacimovska	Mathews	Useini	
2018-10-04	4	Vaso/ Jacimovska	Mathews	Useini	
2019-05	5	Jacimovska	Mathews	Useini	

**PËRMBAJTJA**

<b>1.</b>	<b>HYRJE .....</b>	<b>1</b>
<b>1.1.</b>	<b>OBJEKTIVI DHE FUSHËVEPRIMI I DOKUMENTIT .....</b>	<b>1</b>
1.2.	PËRSHKRIMI I PROJEKTIT .....	1
1.3.	STATUSI I AKTIVITETEVE TË PËVETËSIMIT TË TOKËS .....	4
1.3.1.	Statusi aktual i përvetësimit të tokës .....	4
1.3.2.	Procesi i planifikuar i përvetësimit të tokës.....	5
<b>2.</b>	<b>KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE .....</b>	<b>5</b>
<b>2.1.</b>	<b>LIGJI PËR SHPRONËSIM I KOSOVËS .....</b>	<b>5</b>
2.1.1.	Interesi Publik.....	6
2.1.2.	Kërkesa për Shpronësim.....	6
2.1.3.	Vendimi preliminar mbi legjitimitetin e shpronësimit të propozuar .....	6
2.1.4.	Vendimi përfundimtar mbi shpronësimin .....	6
2.1.5.	Kompensimi.....	7
2.1.6.	Vlerësimi i pronës .....	7
2.1.7.	Data përfundimtare .....	8
2.1.8.	Konsultimi publik .....	8
2.1.9.	Menaxhimi i ankesave.....	8
<b>2.2.</b>	<b>LEGJISLACIONI TJETËR I NDËRLIDHUR .....</b>	<b>9</b>
<b>2.3.</b>	<b>KËRKESAT E BERZH-it .....</b>	<b>12</b>
<b>2.4.</b>	<b>KORNIZA INSTITUCIONALE PËR PËRVETËSIMIN E TOKËS NË KOSOVË.....</b>	<b>13</b>
<b>2.5.</b>	<b>ANALIZA E HENDEQEVE DHE MEKANIZMAT E PËRAFRIMIT .....</b>	<b>13</b>
<b>3.</b>	<b>INFORMACIONI BAZË .....</b>	<b>19</b>
<b>3.1.</b>	<b>REGJISTRIMI I PËRGJITHSHËM .....</b>	<b>19</b>
<b>3.2.</b>	<b>ANKETA SOCIO-EKONOMIKE.....</b>	<b>20</b>
<b>3.3.</b>	<b>NDIKIMET E IDENTIFIKUARA.....</b>	<b>20</b>
<b>3.4.</b>	<b>NJERËZIT DHE PRONAT E PREKURA.....</b>	<b>21</b>
3.4.1.	Anëtarët e familjes.....	21
3.4.2.	Përkatësia etnike .....	21
3.4.3.	Prodhimi bujqësor .....	21
3.4.4.	Cenueshmëria.....	21
3.4.5.	Humbjet e perceptuara .....	22

---

3.4.6.	Preferencat e Kompensimit.....	22
3.4.7.	Bizneset.....	22
<b>4.</b>	<b>PARIMET KRYESORE TË KOMPENSIMIT, PËRKUFIZIMET DHE ÇËSHTJET .....</b>	<b>22</b>
<b>5.</b>	<b>KOMPENSIMI DHE TË DREJTAT .....</b>	<b>24</b>
<b>6.</b>	<b>Shpalosja e informatave dhe konsultimet publike .....</b>	<b>25</b>
<b>6.1.</b>	<b>SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET TË MBAJTURA DERI MË SOT .....</b>	<b>26</b>
<b>6.2.</b>	<b>MJETET E KOMUNIKIMIT NË DISPOZICION .....</b>	<b>26</b>
<b>6.3.</b>	<b>SHPALOSJA E PLANIFIKUAR E INFORMACIONIT DHE KONSULTIMET .....</b>	<b>26</b>
6.3.1.	Dokumentet dhe informacionet që do të shpalosen.....	27
6.3.2.	Vizitat tek Njerëzit e Prekur Drejtpërdrejtë .....	27
6.3.3.	Takimet e planifikuara.....	28
<b>7.</b>	<b>IMPLEMENTIMI I PPT-Së .....</b>	<b>29</b>
<b>7.1.</b>	<b>PËRGJEGJËSITË PËR IMPLEMENTIM .....</b>	<b>29</b>
<b>7.2.</b>	<b>KOSTOT .....</b>	<b>30</b>
<b>7.3.</b>	<b>MONITORIMI DHE RAPORTIMI .....</b>	<b>30</b>
<b>8.</b>	<b>MEKANIZMI I ANKESAVE .....</b>	<b>31</b>

**SHTOJCAT**

Shtojca 1 Kërkesa për shpronësim (përkthim kortezie) Shtojca

2 Formulari i ankesës

Shtojca 3 Grafiku për procesimin/përpunimin e ankesave

**TABELAT**

Tabela 1: Legjislacioni në Republikën e Kosovës relevant për implementimin e projektit .....11

Tabela 2: Analiza e hendeqeve relevante për shpronësimin dhe mekanizmat e propozuar  
përafrues/tejkalues.....14Tabela 3: Përmbledhje e ndikimeve të projektit lidhur me përvetësimin e tokës sipas Elaboratit të  
Shpronësimit .....21

Tabela 4: Matrica e të drejtave .....24

Tabela 5: Përgjegjësitë e implementimit të PPT-së.....29

**FIGURAT**

Figura 1: Harta e rrugëve të Republikës së Kosovës (Burimi: Ministria e Infrastrukturës).....3

## 1. HYRJE

### 1.1. OBJEKTIVI DHE FUSHËVEPRIMI I DOKUMENTIT

Ky dokument është Plani i Përvetësimit të Tokës (PPT) për Projektin e Rrugëve Rajonale të Kosovës që zbatohet nga Ministria e Infrastrukturës e Kosovës, për seksionin **M25.3 rruga Kllokot - Giljan**. Është përgatitur në përputhje me ligjet e Kosovës, si dhe me kërkesat e Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), Politikën Mjedisore dhe Sociale 2014<sup>1</sup> dhe Kërkesat e saj të Performancës (KP), veçanërisht KP 5: Përvetësimi i Tokës, Risistemimi Jovullnetar dhe Zhvendosja Ekonomike. PPT të hollësishëm të veçantë janë duke u përgatitur për seksionet tjera të rrugëve në kuadër të këtij Projekti.

PPT përcakton procedurat që duhet të ndiqen nga Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së saj të Infrastrukturës (MI), si dhe veprimet që do t'i ndërmarrë për kompensimin e duhur të personave të prekur. Dokumenti ofron një përshkrim të tokës, ekonomive familjare dhe bizneseve që do të ndikohen nga përvetësimi i pronës në Komunitet e Kllokotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit. Qëllimi i këtij PPT është që t'i zvogëlojë ndikimet negative të përvetësimit të tokës dhe kufizimet në përdorimin dhe qasjen në tokën nga personat e prekur, si dhe të përcaktojë të drejtat e kategorive të ndryshme të personave të prekur, duke i kushtuar vëmendje të veçantë atyre më të cënueshëm.

PPT zbatohet për të gjithë personat e prekur, pavarësisht numrit të përgjithshëm të personave të prekur dhe pavarësisht nëse janë titullarë të regjistruar ligjërisht të tokës. Sidoqoftë, shkalla e ndikimit do të ndikojë në natyrën e kompensimit dhe ndihmës tjetër të ofruar. Ky dokument PPT është rezultat i konsultimeve, grumbullimit të të dhënave dhe analizave të bëra nga Konsulenti, iC consulenten, dhe përfshin masa për të mbrojtur jetesën e personave të prekur. PPT është përgatitur në bazë të Kornizës për Përvetësim të Tokës (KPT), e cila është hartuar në vitin 2015 si pjesë e projektit të vigjilencës së duhur “Kosovë – Rrugët Rajonale dhe Lokale – Vlerësimi Mjedisor dhe Social”, i cili është kryer nga Enova, Consultants and Engineers, në Sarajevë.

Kërkesat e këtij PPT janë detyruese si për Qeverinë e Kosovës, përmes MI-së, ashtu dhe për Kontraktuesit që do të punësohen për të marrë përsipër ndërtimin dhe funksionimin e Projektit.

### 1.2. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) është duke shqyrtuar ofrimin e financimit MI-së në mbështetje të punëve për përmirësimin e rrugëve nacionale në kuadër të Projektit të Rrugëve Rajonale të Kosovës (Projekti). Projekti përfshin zgjerimin në katër korsi të rrugëve hyrëse/dalëse në Komunitet e Gjilanit, Ferizajt dhe Prizrenit dhe rehabilitimin e seksionit të rrugës Kllokot – Giljan. Këto seksione konsiderohen projekte me prioritet në kuadër të *Strategjisë të Transportit Multimodal (2012-2021)* dhe *Planit të Veprimit (2012-2016)* të Kosovës. Vigjilenca e duhur për projektin është përfunduar në vitin 2015 dhe është krijuar Korniza për Përvetësim të Tokës (KPT) për seksionet e

<sup>1</sup> Teksti i plotë i PMS BERZH është në dispozicion në:  
<http://www.ebrd.com/news/publications/policies/environmental-and-social-policy-esp.html>

Projektit duke përdorur informacionin që në atë kohë ishte në dispozicion të konsulentit<sup>2</sup>. PPT e vecantë është zhvilluar për seksionin e rrugës së Prizrenit dhe dy Plane të Përvetësimit të Tokës dhe Restaurimit të Jetesës (PPTRJ) për seksionet e rrugëve të Ferizajt dhe Gjilanit.

Rruga nacionale M 25-3 i takon rrjetit kryesor të rrugëve nacionale në Kosovë dhe është një degë e rrugës nacionale M 25 që vjen nga Nishi (Republika e Serbisë) deri në kufirin verilindor me Republikën e Serbisë, përmes Prishtinës dhe Prizrenit, deri në kufirin jugor me Shqipërinë. Kjo rrugë korrespondon me Rrugën 7 të Rrjetit Qendror të Rrugëve të Observatorit të Transportit të Evropës Juglindore (SEETO)<sup>3</sup> (Figura 1). Ky seksion është një rrugë e rëndësishme tranzit midis vendbanimeve të Kllokotit dhe Livoqit të Poshtëm, menjëherë jashtë zonës urbane të Komunës së Gjilanit. Është gjithashtu një rrugë tranzit midis komunave të Ferizajt dhe Gjilanit.

---

<sup>2</sup> KPT është në dispozicion për publikun në: [http://mi-ks.net/repository/docs/2016\\_02\\_15\\_081438\\_Kosovo\\_Roads\\_LAF\\_final\\_8\\_Dec\\_2.pdf](http://mi-ks.net/repository/docs/2016_02_15_081438_Kosovo_Roads_LAF_final_8_Dec_2.pdf)

<sup>3</sup> Sipas Memorandumit të Mirëkuptimit për Zhvillimin e Rrjetit Qendror të Transportit Rajonal të Evropës Juglindore, nënshkruar në qershor 2004 nga pjesëmarrësit: Shqipëria, Bosnja dhe Hercegovina, Kroacia, IRJ e Maqedonisë, Mali i Zi, Serbia dhe Kosova (nën RKSKB 1244/99), Rrjeti Qendror është një rrjet multimodal i cili përfshin lidhjet rrugore, hekurudhore dhe të brendshme ujore në shtatë pjesëmarrësit, së bashku me një numër portesh detare, portesh lumore dhe nyjave aeroportuale.



**Figura 1: Harta e Rrugëve të Republikës së Kosovës (Burimi: Ministria e Infrastrukturës)**

Sipas dokumenteve të projektimit<sup>4</sup>, gjatësia e seksionit është 14.5 km, si vijon:

- seksioni me dy korsi midis Klllokotit dhe Livqit të Poshtëm me një gjatësi prej 11,000 m (ky nën-seksion do të financohet nga BERZH); dhe

<sup>4</sup> Raporti Teknik, Rehabilitimi i rruges Nationale N25.3, segmenti Klllokot-Gjilan (Vizion Project, 2016)



- seksioni me katër korsi midis Livoqit të Poshtëm dhe Gjilanit, me një gjatësi prej 3,125 m (ky nën-seksion financohet nga Qeveria e Kosovës dhe punët ndërtimore tanimë janë duke vazhduar në terren).

Ky PPT ka të bëjë vetëm me seksionin e parë (që gjendet ndërmjet vendbanimeve të Kllokotit dhe Livoqit të Poshtëm) pasi ai bie nën paketën e tenderit që do të financohet nga Banka.

Gjatësia e rrugës që është objekt i këtij PPT-je është 11.000 m nga Kllokoti dhe përfundon në Livoq i Poshtëm.

Dizajni i karrexhatës dhe trotuarit: Rehabilitimi i rrugës ekzistuese me një karrexhatë me një korsi dhe shtresave nën-bazë brenda trasesë/shtrirjes ekzistuese, me karrexhatë me gjerësi prej 8,7 m, me anësore (2 m).

Toka përreth seksionit rrugor është pjesërisht e urbanizuar dhe në pjesë të tjera ajo është përgjatë parcelave bujqësore në të dyja anët. Në afërsi të rrugës, përveç shtëpive individuale të banimit, ku ajo kalon nëpër apo afër vendbanimeve Kllokot, Radivojc, Budrikë e Eperme, Partesh, Cërnica, Budrikë e Poshtme dhe Livoq i Poshtëm, ka një numër të veprimtarive të biznesit. Ndikimet do të kufizohen në strukturat dhe veprimtaritë tregtare jo-bujqësore (siç përcaktohet në Seksionin 3.3 të këtij dokumenti). Pritet që gjithsej **11 parcela** (në pronësi formale të një ose më shumë pronarëve) do të preken nga marrja e tokës si rezultat i implementimit të Projektit. Marrja e parcelave individuale të tokës është rezultat i sjelljes së dizajnit të rrugës brenda standardit dhe jo si pasojë e zgjerimit të rrugës, pasi është planifikuar të mbajë rrugën brenda shtrirjes ekzistuese. Prandaj, ndikimet në parcelat individuale janë shumë të kufizuara dhe nuk prekin funksionin e përgjithshëm të parcelave të prekura.

Në kuadër të projektit të vigjilencës së duhur nuk është regjistruar asnjë grup i veçantë i cenuar gjatë vizitave në terren të zhvilluara në vitin 2015, gjë që u konfirmua në regjistrimin e shtatorit të vitit 2017. Asnjë strukturë e trashëgimisë kulturore të asnjë lloji nuk u regjistrua si në vitin 2015 dhe u konfirmua në 2017.

### **1.3. STATUSI I AKTIVITETEVE TË PËVETËSIMIT TË TOKËS**

#### **1.3.1. Statusi aktual i përvetësimit të tokës**

MI, si parashtrues i kërkesës e ka dërguar kërkesën për Shpronësim (Referenca: 5197/2017, e datës 22 qershor 2017) në Zyrën e Shpronësimit të MMPH, duke iniciuar zyrtarisht procedurën e shpronësimit në përputhje me legjislacionin kombëtar (shih kapitullin 2 të këtij dokumenti për përshkrimin e procedurës), pas komisionit dhe kompletimit të Elaboratit të Shpronësimit për Rehabilitimin e rrugës nacionale N25.3, Seksioni: Kllokot - Gjilan (Vizion Project, gusht 2016).

Bazuar në të dhënat më të fundit të ofruara nga Ministria e Infrastrukturës, MMPH ka pranuar kërkesën gjatë Dhjetorit 2017 (Vendimi nr. 11/21, datë 22.12.2017), të dorëzuar nga MI më herët këtë vit. Afati ligjor sipas Ligjit për Shpronësim të Kosovës është 15 ditë pas marrjes së kërkesës, përkatësisht Kërkesës për Shpronësim (Shtojca 1 e këtij dokumenti). Megjithatë, procesi i shpronësimit është ende në një fazë të hershme pasi që Ministria e Financave dhe Zyra e saj për Pronën e Paluajtshme ende mbetet të përcaktojnë shumën e kompensimit për secilin grup të prekur. Domethënë, vetëm zona e parcelave që do të preken është definuar në Elaborat dhe të gjitha ndikimet e projektit në lidhje me shpronësimin e tokës ende nuk janë përcaktuar (dmth. nuk është bërë vlerësim në kohën e hartimit të këtij dokumenti). Qeveria e Kosovës ka njoftuar bartësit e identifikuar të drejtave pronësore. Vendimi nr. 11/21 mbi miratimin u publikua në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë ditore me tirazh të madh në Kosovë,

i cili publikim përsëritet pas 7 deri në 10 ditë, pasuar me një periudhë 10-ditore gjatë së cilës palët e interesuara kanë të drejtë të dorëzojnë komente me shkrim tek organi shpronësues. Pas publikimit, nga autoriteti shpronësues është kërkuar të mbajë një dëgjim publik brenda 15 ditëve në secilën komunë përkatëse ku ndodhen pronat që i nënshtrohen shpronësimit, gjë e cila është realizuar gjatë janarit 2018. Pritet që gjithsej 11 parcela private në Zonat kadastrale të Kllokotit, Radivoicit, Budrikë e Epërme dhe Parteshit do të preken nga marrja e tokës, me një total prej 4.452 m<sup>2</sup>, siç është identifikuar në Elaboratin e Shpronësimit.

I gjithë procesi është iniciuar vetëm për pronarët formal të tokave / përdoruesit e tokave pasi që legjislacioni i Kosovës nuk i njej shfrytëzuesit/përdoruesit joformal të tokës (shih seksionin 2.5 të këtij dokumenti për përshkrimin e boshllëqeve ndërmjet legjislacionit të Kosovës dhe kërkesave të BERZH-it). Sidoqoftë, nuk pritët që përdoruesit joformal do të ndikohen nga implementimi i Projektit.

Kohët e fundit gjatë periudhës janar-mars 2019, ndryshimi në hartimin e projektit është bërë për të përfshirë modifikimet në lidhje me stacionet e autobusëve dhe trotuaret për këmbësorët me qëllim përmirësimin e rrugës dhe sigurisë në pëgjithësi. Megjithatë, marrja e kërkuar e tokës mbetet e njëjtë meqë ndryshimet janë brenda linjës së mëparshme të planifikuar të shpronësimit.

### **1.3.2. Procesi i planifikuar i përvetësimit të tokës**

Sipas procedurës së përcaktuar në legjislacionin kombëtar, MMPH-së i kërkohej që të jetë në kontakt me AKK-në për të siguruar që informacioni i paraqitur në Elaboratin e Shpronësimit është i përditësuar dhe i saktë. Pasi që ishte konfirmuar se Elaborati i Shpronësimit është i saktë, MMPH ka miratuar Vendimin nr. 11/21 të datës 22.12.2017, për pranimin e kërkesës për përpunim të mëtejshëm dhe ka dërguar një kopje të kërkesës dhe dokumenteve shoqëruese në Zyrën e Vlerësimit të Pronës së Paluajtshme brenda Ministrisë së Financave (MF) për vlerësimin e pronave të prekura. Elaborati i Shpronësimit është duke u mbajtur aktualisht në Ministrinë e Financave, përkatësisht në Zyrën e Pronës së Paluajtshme brenda Departamentit të Tatimit në Pronë, në pritje të procedurës administrative të përcaktuar në Ligjin e Kosovës për Shpronësim (shih Seksionin 2.4).

Prandaj nuk ka ende një afat kohor të përcaktuar për procesin në pritje të përvetësimit të tokës. Sipas Nenit 16 të Ligjit për Shpronësim, "*Shuma e kompensimit të shpronësimit e përcaktuar në vendimin përfundimtar paguhet plotësisht brenda dy (2) viteve nga data e hyrjes në fuqi të vendimit*". Sipas përvojës së NJIP nga projekte të ngjashme, kohëzgjatja e parashikuar e tërë procedurës së shpronësimit zgjat rreth 2 - 3 vjet.

## **2. KORNIZA LIGJORE DHE INSTITUCIONALE**

### **2.1. LIGJI PËR SHPRONËSIM I KOSOVËS**

Procedura e shpronësimit të tokës dhe risistemimit/rivendosjes në Kosovë rregullohet kryesisht me *Ligjin Nr. 03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme me ndryshimet dhe plotësimet e bëra në Ligjin Nr. 03/L-205 të datës 28 tetor 2010* (Ligji për Shpronësim i Kosovës). Ligji përshkruan procedurën, duke përfshirë mjetet juridike, për të mbrojtur individët nga ndërhyrjet joproporcionale në të drejtën e pronës së paluajtshme<sup>5</sup>. Dispozitat kryesore të këtij Ligji janë përmbledhur më poshtë.

#### **2.1.1. Interesi Publik**

Shpronësimi mund të kryhet vetëm kur të plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme (Neni 4):

- i. shpronësimi bëhet në mënyrë të qartë dhe të drejtpërdrejtë për arritjen e një qëllimi të ligjshëm publik;
- ii. qëllimi i ligjshëm publik nuk mund të arrihet në mënyrë praktike pa kryerjen e Shpronësimit;
- iii. përfitimi publik nga shpronësimi është më i madh se interesat të cilat do të ndikohen negativisht nga Shpronësimi;
- iv. prona e paluajtshme e cila është objekt i shpronësimit nuk është zgjedhur për arritjen e një qëllimi ose synimi diskriminues; dhe,
- v. Organi Shpronësues i ka përmbushur të gjitha dispozitat e aplikueshme të këtij ligji.

### **2.1.2. Kërkesa për Shpronësim**

Fillimi i procedurës së shpronësimit kryhet nga vetë Organi Shpronësues (MMPH) ose përmes një kërkesë për shpronësim të dorëzuar në organin shpronësues (neni 7), në këtë rast nga MI-ja në MMPH. Kërkesa përmban informacionin e nevojshëm mbi bartësit e të drejtës pronësore dhe pronat e prekura, përshkrimi i të gjitha të drejtave që kanë të bëjnë me një parcelë, përshkrimin e hollësishëm të qëllimit publik për të cilin kërkohet shpronësimi, të shoqëruar me dokumente që përfshijnë të dhënat e pronësisë, planet kadastrale, hapësinore ose urbanistike dhe dëshmi se ka ose do të ketë mjete të mjaftueshme financiare në dispozicion për pagesën në kohë të kompensimit.

Pas pranimit të kërkesës, organi shpronësues e shqyrton kërkesën dhe mund ta miratojë ose refuzojë kërkesën, tërësisht ose pjesërisht.

Në rast miratimi, autoriteti shpronësues dërgon një kopje të kërkesës dhe të gjitha dokumentet e bashkangjitura në Zyrën për Vlerësimin e Pasurisë së Paluajtshme dhe i njofton bartësit e identifikuar të të drejtave të pronësisë. Vendimi për miratim publikohet në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë të përditshme në Kosovë që gëzon një qarkullim të gjerë, i cili publikim përsëritet pas 7 deri në 10 ditë, pasuar me një periudhë 10-ditore gjatë së cilës palët e interesuara kanë të drejtë t'i paraqesin komente me shkrim autoritetit shpronësues. Pas publikimit, autoritetit shpronësues i kërkohet të mbajë një dëgjim publik brenda 15 ditëve në secilën komunë ku ndodhen pronat që i nënshtrohen shpronësimit.

### **2.1.3. Vendimi Preliminar mbi Legjitimitetin e Shpronësimit të Propozuar**

Pas shqyrtimit të komenteve me shkrim dhe shqetësimeve të shprehura në dëgjimet publike, organi shpronësues miraton një Vendim Preliminar brenda 30 ditëve (neni 10). Organi mund të refuzojë shpronësimin bazuar në këto komente dhe shqetësime, ose në rast se përcakton që shpronësimi i propozuar nuk i plotëson kërkesat ligjore. Vendimi preliminar publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetën ditore.

---

<sup>5</sup> Sipas ligjit, prona e paluajtshme përfshinë: (i) tokën, (ii) ndërtesat ose pjesët e veçanta të një ndërtese të ndërhuara në, mbi ose nën sipërfaqen e tokës si dhe (iii) pjesët përbërëse dhe sendet aksesore të cilat i janë bashkuar tokës ose ndërtesës në bazë të përhershme dhe të cilat nuk mund të largohen pa përpjekje të paarsyeshme ose jo-ekonomike, dhe (iv) frutat e pashkëputura nga toka.

#### **2.1.4. Vendimi Përfundimtar mbi Shpronësimin**

Organi shpronësues miraton Vendimin Përfundimtar duke e aprovuar ose refuzuar kërkesën gjatë një periudhe 12-mujore pas hyrjes në fuqi të Vendimit Preliminar (neni 11). Vendimi përfundimtar publikohet në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në gazetën ditore. Vendimi përfundimtar nuk mund të miratohet në rast se ndonjë ankesë kundër vendimit preliminar lidhur me pronat e prekura ende është në pritje në gjykatë. Nëse kërkesa mbulon më shumë se një parcelë të pronës, organi shpronësues mund të lëshojë një ose më shumë vendime përfundimtare, ku secili nga këto vendime përfundimtare mbulon një ose më shumë parcela në fjalë.

#### **2.1.5. Kompensimi**

Kompensimi rregullohet me Ligjin për Shpronësim i Kosovës dhe *Udhëzimin Administrativ Nr. 02/2015 për Miratimin e Metodave dhe Kriteve Teknike të Vlerësimit për Llogaritjen e Shumës së Kompensimit për Pronën e Paluajtshme që Shpronësohet dhe Dëmeve që kanë të bëjnë me Shpronësimin*, të miratuar në 2015 nga Ministria e Financave në bazë të Ligjit. Sipas Ligjit, kompensimi bëhet në bazë të vlerës së tregut të pronës<sup>6</sup>, duke përfshirë pjesët aksesore dhe frutat e saj, plus çdo dëmzim të dukshëm të drejtpërdrejtë të shkaktuar për shkak të shpronësimit. Kompensimi paguhet në mjete monetare<sup>7</sup>, dhe përfshin shumën e përcaktuar në Vendimin Përfundimtar plus interesin në shumën e tillë që është grumbulluar në mes të datës së hyrjes në fuqi të vendimit përfundimtar dhe datës së pagesës.

Asnjë ndryshim në pronësi ose të drejta të tjera të personave të prekur nuk hyjnë në fuqi ose zbatohen derisa të hyjë në fuqi vendimi përfundimtar dhe të jetë paguar kompensimi i kërkuar nga vendimi përfundimtar. Vetëm pasi të jenë plotësuar kushtet e përmendura, prona regjistrohet në emër të Qeverisë së Kosovës.

#### **2.1.6. Vlerësimi i Pronës**

Zyra për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme është përgjegjëse për vlerësimin e pronës në proces të shpronësimit (neni 21 dhe neni 22), në bazë të Udhëzimit Administrativ të lartpërmendur, i cili rregullon metodologjinë e hollësishme për llogaritjen e kompensimit që duhet paguar për pronat e shpronësuar dhe dëmet e ndërlidhura me shpronësimet<sup>8</sup>. Një nga metodat e mëposhtme ose metodat e kombinuara të vlerësimit të pronës mund të përzgjidhen gjatë vlerësimit të pronës së paluajtshme:

- Metoda e shitjeve krahasuese,
- Metoda e kostos, dhe
- Metoda e të ardhurave.

Vlera e pronës që konsiderohet si tokë bujqësore merr parasysh cilësinë e tokës, afërsinë me vendbanimin, qasjen në infrastrukturë, madhësinë dhe formën e parcelës, sistemin e ujitjes ose potencialin e ujitjes, si dhe kushtet e tjera mjedisore që lidhen me karakteristikat fizike të terrenit (lartësia dhe pjerrësia). Vlera e tokave pyjore dhe pyjeve

<sup>6</sup> Vlera e tregut përkufizohet si: "çmimi që blerësi është i gatshëm të paguajë dhe shitësi të shes pronën e paluajtshme në një transaksion zyrtar, kur asnjëri nuk është i detyruar të veprojë me forcë dhe nuk ka marrëdhënie ndërmjet palëve në bazë të gjakut, martesës, pronësisë të përbashkët ose lidhjeje biznesi."

<sup>7</sup> Kompensimi në natyrë sipas mënyrës tokë për tokë (ose një kombinim në natyrë dhe në para të gatshme) sigurohet ekskluzivisht në rastet kur Qeveria është organi shpronësues dhe më shumë se 20 parcela të pronës së paluajtshme shpronësohen, nëse pronarët e pronave të tilla janë dakord.

<sup>8</sup> Ligji për Shpronësim thotë se "Kompensimi përfshin kompensimin e çdo dëmi të drejtpërdrejtë i cili mund të dëshmohet, i cili i shkaktohet personit të shpronësuar si pasojë e shpronësimit plus vlerën e pronës së paluajtshme të shpronësuar, duke përfshirë – nëse është e aplikueshme - pjesët aksesore dhe frutat e saj"

përcaktohet duke marrë parasysh cilësinë e tokës, vlerën mjedisore të tokës, vendndodhjen gjeografike, sasinë dhe cilësinë e biomasës, nivelin e investimeve dhe qasjen në infrastrukturë, kushtet e transportit dhe kushtet mjedisore. Vlerësimi i zonave të banuara dhe të tjera të ndërtuara merr parasysh kriteret siç janë: lloji i ndërtesës, materiali ndërtimor, sipërfaqja në m<sup>2</sup> për strukturat banesore dhe jo-banesore, viti i ndërtimit, qasja në rrugë, qasja në shërbimet publike, sistemi i ngrohjes, gjendja e objektit, marrjen me qira dhe kushtet e qirasë, kosto e operimit dhe mirëmbajtjes, etj. Gjatë procesit të vlerësimit, pronarët dhe zotëruesit e interesave kanë të drejtë të paraqesin pikëpamjet e tyre me shkrim në Zyrën respektive, në lidhje me vlerësimin e tillë dhe të kundërshtojnë vendimet e vlerësimit përfundimtar të Zyrës në gjykata.

#### **2.1.7. Data Përfundimtare**

Ligji për Shpronësim i Kosovës (neni 7) përcakton datën përfundimtare me vendimin e pranimit të kërkesës për shpronësim dhe publikimit të vendimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës dhe në ndonjë gazetë që gëzon qarkullim të gjerë në Kosovë.

Ligji për Shpronësim i Kosovës në mënyrë specifike parashikon që do të përjashtohen nga shumica e kompensimit si vijon:

- kosto ose vlera e çfarëdo përmirësimi të pronës, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemët ose bimët e mbjella në pronë pas datës së publikimit në Gazetën Zyrtare të vendimit të pranimit të kërkesës për shqyrtim të mëtutjeshëm të shpronësimit (lëshuar para vendimit preliminar),
- çfarëdo ndryshimi në vlerën e tregut të pronës që ka ndodhur qoftë pas datës së miratimit të vendimit për autorizimin e kryerjes së punëve përgatitore në pronë e tillë, ose datës së paraqitjes fillestare të kërkesës për shpronësim cilado që paraqitet më herët,
- çfarëdo ndryshimi në vlerën e tregut të pronës së paluajshme i cili ndodh para fillimit të procedurës së shpronësimit, nëse ky ndryshim mund të dëshmohet se ka ardhur si rezultat i manipulimit të çmimit ose tregut ose spekulimeve nga personat (ose të afërmit apo bashkëpunëtorët e tyre) që kanë pasur informata mbi shpronësimin e prishëm ose të mundshëm të pronës përkatëse.

#### **2.1.8. Konsultimi Publik**

Ligji për Shpronësim i Kosovës u siguron personave të prekur me mekanizmat ligjor të konsultimit publik (neni 9), pas publikimit të Vendimit të Pranimit të kërkesës për shpronësim në media, kur çdo palë e interesuar ka të drejtë të paraqes tek organi shpronësues komentet me shkrim mbi shpronësimin në fjalë. Pas kësaj, organi shpronësues organizon një dëgjim publik në Komunën ku do të bëhet shpronësimi. Personat të cilët dëshirojnë të marrin pjesë në këto dëgjime publike duhet të ofrojnë dëshmi se janë zyrtarë publikë të Komunës aty ku zhvillohet dëgjimi publik, ose ndonjë pronar ose zotërues i interesit në lidhje me pronën në fjalë që gjendet në atë Komunë ku zhvillohet dëgjimi publik, ose avokat i ligjshëm ose përfaqësues i një zyrtari të tillë publik, pronari ose zotëruesi i interesit.

#### **2.1.9. Menaxhimi i Ankesave**

Ankesat e përcaktuara me Ligjin për Shpronësim të Kosovës përfshijnë: (i) ankesat që kundërshtojnë vendimin preliminar për legjitimitetin e shpronësimit të propozuar, (ii) ankesat që kundërshtojnë përshtatshmërinë e kompensimit, (iii) ankesat për kompensimin e dëmeve që rrjedhin nga shpronësimi i pjesshëm; (iv) ankesat që kundërshtojnë legjitimitetin e vendimit për shfrytëzimin e përkohshëm të pronës.

**2.2. LEGJISLACIONI TJETËR I NDËRLIDHUR**

Legjislacioni tjetër në Kosovë i rëndësishëm për zbatimin e projektit është përmbledhur në Tabelën 1.

Ligji	Përmbledhje dhe pikat kryesore
Kushtetuta e Republikës së Kosovës	Kushtetuta ndalon privimin arbitrar të pronës (neni 46) - autoriteti mund të bëjë ekspropriimin e pronës nëse ky ekspropriim është i autorizuar me ligj, është i nevojshëm ose i përshtatshëm për arritjen e qëllimit publik ose përkrahjen e interesit publik, dhe pasohet me sigurimin e kompensimit të menjëhershëm dhe adekuat për personin ose personat prona e të cilave ekspropriohehet.
Ligji për pronësinë dhe të drejtat tjera sendore nr. 03/L-154 i datës 15 korrik 2009	Ky ligj rregullon krijimin, përmbajtjen, bartjen, mbrojtjen si dhe shuarjen e të drejtave sendore siç janë pronësia, të drejtat sendore të kufizuara, posedimin, të drejtat sendore të sigurimit si dhe të drejtat sendore të shfrytëzimit. Parasheh që pronësia dhe të drejtat sendore të tjera mund të kufizohen ose të merren kundër vullnetit të titullarit vetëm sipas kushteve dhe procedurave të përcaktuara me ligj.
Ligji për kadastrën Nr. 04/L-013 i datës 12 gusht 2011	Rregullon kadastrin e palujtshmërive, matjet shtetërore dhe kadastrale, punët gjeodezike dhe kadastrale si dhe përfitimin, regjistrimin, ruajtjen, mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të dhënave kadastrale.
Ligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 2002/5 për themelimin e Regjistrimit të të drejtave të pronës së paluajtshme No. 04/L009 i datës 21 korrik 2011	Përcakton parimet e zbatimit dhe validimit të të drejtave të pronës së paluajtshme në Kosovë përmes mekanizmit të Regjistrimit të të Drejtave të Pronës së Paluajtshme. Të drejtat e pronës së paluajtshme, duke përfshirë (i) pronësinë, (ii) hipotekat, (iii) servitutët, (iv) të drejtat e përdorimit të pronës komunale, publike, sociale dhe shtetërore dhe (v) ngarkesat e pronës regjistrohen në Regjistër. Përcakton autoritetin mbi administrimin e përgjithshëm të Regjistrimit në Agjencinë Kadastrale të Kosovës (AKK) dhe cakton Zyrat Kadastrale Komunale (ZKK) për të regjistruar, me shkrim, të drejtat e pronës së paluajtshme në Regjistër nën autoritetin e AKK-së
Ligji për procedurën administrative nr. 02/L-28 i datës 22 korrik 2005	Përcakton parimet që do të zbatohen nga të gjitha organet e administratës publike gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre nëpërmjet akteve individuale dhe kolektive. Organet e administratës publike, në ushtrim të veprimtarisë administrative, duhet të vendosin një balancim të drejtë mes interesave publike dhe interesave private të përfshira në të, në mënyrë që të evitohen ndërhyrjet e panevojshme në të drejtat dhe interesat e personave fizik dhe juridik. Organet e administratës publike nuk lejohet të bëjnë dallimet lidhur me personat fizik dhe juridik si mbi baza të gjinisë, gjuhës, opinionit politik ose opinionit tjetër, origjinës kombëtare ose sociale, pasurisë, lindje ose ndonjë statusi tjetër, gjatë veprimtarisë administrative. Çdo person fizik dhe juridik ka të drejtë të (i) të marrë informacion që është në zotërim të një organi të administratës publike, (ii) të marrë informacion brenda një kohe të arsyeshme, (iii) në të njëjtën mënyrë si për çdo person tjetër, dhe (iv) me mjete ose format të përshtatshëm dhe efektiv.
Ligji Nr. 04/L-020 për ndryshimin e ligjit për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Kosovë Nr. 03/L-047 i datës 21 dhjetor 2011	Përkufizon komunitetet e Kosovës dhe të drejtat e tyre speciale sa i përket identitetit të tyre, besimit, arsimit, përdorimit të gjuhëve, kulturës, shëndetit, medias, mundësive ekonomike dhe sociale, dhe përfaqësimit të tyre politik në të gjitha mekanizmat shtetëror. Ndërmerr masat për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore dhe fetare, programet për punësim publik, veçanërisht për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptas, arsimimin në gjuhën e tyre, etj.

Ligji	Përmbledhje dhe pikat kryesore
Ligji për përdorimin e gjuhëve Nr. 02/L-37 i datës 21 tetor 2006	Rregullon përdorimin e gjuhëve zyrtare, si dhe të gjuhëve të komuniteteve, gjuha amtare e të cilave nuk është gjuhë zyrtare, në institucionet e Kosovës dhe në ndërmarrje dhe organizata të tjera publike. I ofron status të barabartë gjuhës shqipe dhe serbe si gjuhë zyrtare në Kosovë. Ofron të drejtën e të gjitha komuniteteve të Kosovës për të ruajtur, mbrojtur dhe promovuar identitetin e tyre gjuhësor.
Ligji për mbrojtjen nga diskriminimi Nr. 05/L-021 i datës 15 qershor 2015	Përcakton kornizën e përgjithshme për parandalimin dhe luftimin e diskriminimit në bazë të kombësisë apo lidhjes me ndonjë komunitet, origjinës sociale apo kombëtare, racës, etnisë, ngjyrës, lindjes, origjinës, seksit, gjinisë, identitetit gjinor, orientimit seksual, gjuhës, shtetësisë, besimit fetar dhe besimit, përkatësisë politike, mendimit politik apo mendimeve të tjera, gjendjes sociale ose personale, moshës, gjendjes familjare ose martesore, shtatzënisë, lehonisë, gjendjes pasurore, gjendjes shëndetësore, aftësisë së kufizuar, trashëgimisë gjenetike ose ndonjë baze tjetër, me qëllim të zbatimit të parimit të trajtimit të barabartë. Ka për qëllim të parandalojë të gjitha veprimet apo mosveprimet, të të gjitha institucioneve shtetërore dhe lokale, të personave fizik dhe juridik, të sektorit publik dhe privat, të cilët shkelin, kanë shkelur ose mund të shkelin të drejtat e çdo personi apo personave fizik dhe juridik, në të gjitha fushat e jetës, e posaçërisht që kanë të bëjnë me (i) qasje në vendbanim, i cili është në dispozicion për publikun, si dhe qasje në forma tjera të pronës (luajtshme dhe paluajtshme) dhe (ii) trajtimi i drejtë dhe i barabartë para organeve gjyqësore dhe të gjitha organeve të tjera që administrojnë drejtësinë.
Ligji mbi barazinë gjinore Nr. 05/L-020 i datës 15 qershor 2015	Ka për qëllim të mbrojë dhe promovojë barazinë midis gjinive, si vlerë themelore për zhvillimin demokratik të shoqërisë.
Ligji për planifikimin hapësinor Nr. 04/L-174 i datës 19 gusht 2013	Përcakton parimet bazë të planifikimit hapësinor, metodologjinë e zhvillimit dhe rregullimit hapësinor, si dhe përgjegjësitë e subjekteve administrative të nivelit qendror dhe lokal për hartimin dhe zbatimin e dokumenteve të planifikimit hapësinor.
Ligji për ndërtim Nr. 04/L-110 i datës 19 qershor 2012	Rregullon procedurën për lëshimin e lejeve ndërtimore, pajtueshmërinë me kërkesat e lejes ndërtimore dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit, projektimin, ndërtimin, rindërtimin, rrënimin, mbikëqyrjen profesionale, inspektimin e ndërtimit.
Ligji për inspektoratin e mjedisit, ujërave, natyrës, planifikimit hapësinor dhe ndërtimit Nr. 04/L-175 i datës 21 tetor 2013	Rregullon parimet, organizimin dhe mbikëqyrjen inspektuese, koordinimin e mbikëqyrjeve inspektuese, të drejtat, detyrat, autorizimet e inspektorit, të drejtat, detyrimet e subjekteve të mbikëqyrjes, procedurën për kryerjen e mbikëqyrjes inspektuese dhe çështje tjera me rëndësi që kanë të bëjnë me mbikëqyrjen inspektuese. Parasheh që mbikëqyrja inspektuese dhe kontrolli përmes inspektimit urbanistik në zbatimin e këtij ligji dhe ligjeve tjera që kanë të bëjnë me fushën e urbanizmit dhe planifikimit hapësinor është përgjegjësi e Inspektoratit të planifikimit hapësinor dhe urbanistik.

Tabela 1: Legjislacioni në Republikën e Kosovës relevant për zbatimin e projektit

### 2.3. KËRKESAT E BERZH-IT

BERZH aplikon Politikën e saj Mjedisore dhe Sociale (2014) në këtë Projekt. Përvetësimi i tokës mbulohet me Kërkesën e Performancës (PR) 5 të Politikës. Pikat kryesore të KP 5 janë si më poshtë:

- Duhet të hulumtohen të gjitha projekt dizajnet alternative të mundshme për të shmangur ose së paku minimizuar zhvendosjen fizike dhe / ose ekonomike;
- Vendbanimet/risistemimet e negociuara inkurajohen të ndihmojnë në shmangien e shpronësimit dhe eliminimin e nevojës për të përdorur autoritetin qeveritar për t'i

larguar njerëzit me forcë;

- Ndikimet e rënda/pafavorshme sociale dhe ekonomike nga përvetësimi i tokës ose kufizimet në përdorimin nga personat e prekur dhe qasjen në tokë duhet të lehtësohen nga: (i) sigurimi i kompensimit për humbjen e aseteve me koston e zëvendësimit; dhe (ii) të sigurojë që aktivitetet e përvetësimit të tokës të zbatohen me dhënien e informacioneve të duhura, konsultimin dhe pjesëmarrjen e informuar të atyre që preken;
- Mjetet e jetesës dhe standardet e jetesës së personave të zhvendosur duhet të përmirësohen ose, së paku, të rikthehen në nivelet e para-projektit;
- Banorët joformal të tokës nuk kanë të drejtë për kompensim të tokës; megjithatë, ata duhet të kompensohen për çdo përmirësim tjetër në tokë dhe t'u sigurohet asistencë për risistemimin/rivendosjen. Ata gjithashtu do të kompensohen me koston e plotë të zëvendësimit të çdo pasuri të humbur përveç tokës;
- Duhet të krijohet një mekanizëm i ankesave në proces sa më shpejt që të jetë e mundur, në mënyrë që të merren dhe adresohen në kohë shqetësimet specifike për kompensimin dhe zhvendosjen që ngrihen nga personat e zhvendosur dhe / ose anëtarët e komuniteteve nikoqire, duke përfshirë një mekanizëm rekursi të hartuar për të zgjidhur mosmarrëveshjet në mënyrë të paanshme.

#### 2.4. KORNIZA INSTITUCIONALE PËR PËRVETËSIMIN E TOKËS NË KOSOVË

Në përputhje me Ligjin për Shpronësim të Kosovës, organi administrativ ("organi shpronësues") i cili është përgjegjës për shpronësimin e tokës për këtë Projekt është Qeveria e Kosovës përmes **Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH)**, duke vepruar si autoritet shpronësues në emër të të gjitha autoriteteve të nivelit qendror<sup>9</sup>.

Institucionet tjera kyçe të përfshira në procesin e shpronësimit janë:

- **Zyra e Vlerësimit të Pasurisë së Paluajtshme** (brenda Departamentit të Tatimit në Pronë) në kuadër të Ministrisë së Financave, autoriteti i vetëm publik kompetent për vlerësimin e çdo prone të paluajtshme që i nënshtrohet shpronësimit nga çdo organ shpronësues (komunë ose qeveria).
- **Agjencia Kadastrale e Kosovës (AKK)**, autoriteti më i lartë i kadastrës, gjeodezisë dhe kartografisë në Kosovë, përgjegjës për administrimin e përgjithshëm të regjistrit të kompjuterizuar të të drejtave mbi pronën e paluajtshme në Kosovë.
- **Zyrat Kadastrale Komunale**, që kërkohet të regjistrojnë (në Regjistrin e të Drejtave të Pronës së Paluajtshme) vendimet përfundimtare për shpronësimin e pronës së paluajtshme (të dorëzuar nga organi shpronësues) me qëllim që t'i pengojë pronarët ose zotëruesit e interesit të transferojnë ose t'i japin ndonjë personi të tretë ndonjë të drejtë pronësie ose të interesit apo të drejtave tjera lidhur me pronën përkatëse, dhe të kryejnë ndonjë punë ndërtimore në pronën përkatëse.

#### 2.5. ANALIZA E HENDEQEVE DHE MEKANIZMAT E PËRAFRIMIT

Tabela 2: **Analiza e hendeqeve që janë relevante për shpronësimin dhe mekanizmat e propozuar për afrues/tejkalues** ofron një pasqyrë të krahasimit të kornizës ligjore të Kosovës për shpronësimet dhe KP 5 të BERZH: përvetësimi i tokës, kërkesat për risistemimet/rivendosjet jovullnetare dhe zhvendosjet ekonomike dhe veprimet që duhen ndërmarrë për të kapërcyer ndonjë mospërputhje të legjislacionit kombëtar me atë të kërkesave të BERZH-it.

<sup>9</sup>Sipas Vendimit të Qeverisë Nr. 05/147 të datës 05 tetor 2010 Zyra e Shpronësimit u krijua në kuadër të MMPH.



Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
Shmangia ose minimizimi i zhvendosjes	Nuk ekziston asnjë dispozitë për shmangien ose minimizimin e zhvendosjes.	Shqyrtimi i projekt dizajnëve të mundshme alternative për të shmangur ose të paktën minimizuar zhvendosjen fizike dhe / ose ekonomike, duke balancuar kostot dhe përfitimet mjedisore, sociale dhe financiare.	Projekti do të mundësojë shqyrtimin e rishtrirjeve/riarranzhimeve mikro me qëllim që të shmanget përvetësimi i tokës aty ku është e mundur, në përputhje me parimet kryesore të përvetësimit / kompensimit të tokës të përcaktuara në PPT.
Planifikimi dhe zbatimi i risistemimit/rivendosjes	Kërkohet vetëm një studim i shpronësimit si regjistrim bazë, asnjë kërkesë e qartë lidhur me anketimet socio-ekonomike ose zhvillim të planeve të risistemimit.	Duhet të bëhet një regjistrim dhe një vlerësim bazë socio- ekonomik për të identifikuar personat që do të zhvendosen dhe për të përcaktuar se kujt do t'i takojë kompensimi dhe asistenca si dhe duhet të përgatitet dhe të zbatohet një plan veprimi për risistemimin/rivendosjen.	Plani i Përvetësimit të Tokës (PPT) përmban një regjistrim të popullsisë dhe një studim socio-ekonomik dhe një matricë të të drejtave/titujve.
Vendosjet e negociuara	Nuk kërkon e as inkurajon vendosjet e negociuara	Inkurajon vendosjet e negociuara për t'iu shmangur shpronësimit dhe për të eliminuar nevojën për të përdorë autoritetin qeveritar për largimin e njerëzve me forcë.	Vendosjet e negociuara do të realizohen aty ku është e mundur, madje edhe përpara fillimit të procesit të shpronësimit, në përputhje me parimet kryesore të përvetësimit / kompensimit të tokës të përcaktuara në PPT.

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
Pranueshmëria/kualifikueshmëria dhe formaliteti	Shpronësimi kryhet vetëm për pronën e paluajtshme dhe strukturat e ndërtimit në pronën e paluajtshme private. Procesi është i zbatueshëm vetëm për strukturat që janë të legalizuara ose që mund të legalizohen sipas ligjeve në fuqi në Kosovë në datën e nxjerrjes së vendimit përfundimtar për shpronësim.	Mungesa e dokumentacionit të pronësisë nuk përjashton nga kualifikimi për ndihmë çdo bartës të pretenduar ose pretendues të pronës, pavarësisht nga statusi i tyre formal.	Prona e paluajtshme duhet të kompensohet pavarësisht nga statusi i formalitetit.
Përdoruesit joformal të tokës dhe autorizimet	Përdoruesit joformal të tokës nuk njihen. Nuk ka provizione mbi të drejtat e kësaj kategorie personash.	Kompensimi që do të sigurohet për përmirësime në tokë dhe humbje të aseteve të ndryshme nga toka dhe asistencë për rivendosje u ofrohet përdoruesve joformal të tokës me kosto të plotë zëvendësimit.	Përdoruesit joformal të tokës të prekur nga humbja e aseteve dhe / ose përmirësimet në tokë do të marrin kompensim me koston e plotë të zëvendësimit.
Sigurimi i kompensimit në vlerë të zëvendësimit	Kompensimi paguhet në bazë të vlerës së tregut të pronës.  Nuk ka udhëzime specifike në rastet kur nevojitet restaurimi i jetesës.	Kompensimi do të sigurohet me kosto të plotë të zëvendësimit, zakonisht i llogaritur si vlera e tregut e aseteve plus kostot e transaksionit që kanë të bëjnë me restaurimin/rikthimin e aseteve të tilla (taksat e regjistrimit dhe transferimit).	Personat e prekur nga humbja e përhershme e parcelave të tokës do të marrin kompensim me koston e plotë të zëvendësimit. Personat e prekur nga tokë do të marrin plotë të zëvendësimit.
Data përfundimtare	Përcakton dispozitat mbi datën përfundimtare, por nuk kërkon që data e tillë të jetë mirë e dokumentuar dhe shpërndarë në të gjithë zonën e projektit. Sipas legjislacionit kombëtar, data përfundimtare do të jetë data kur Organi	Individët që lëvizin/shpërngulen në zonën e prekur të projektit pas datës përfundimtare nuk do të kenë të drejtën për kompensim dhe lloje të tjera të asistencës.  Informatat në lidhje me datën përfundimtare do të dokumentohen mirë dhe shpërndahen në të gjithë zonën e projektit.	Data përfundimtare do të shpalojë dhe shpërndahet publikisht në media dhe takime publike në komunitetet e prekura përkatëse, në përputhje me parimet kryesore të përvetësimit / kompensimit të tokës të përcaktuara në PPT.

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
	<p>shpronësues publikon vendimin për pranimin e kërkesës për përpunim të mëtejshëm në Gazetën Zyrtare dhe në një gazetë që gëzon qarkullim të gjerë në Kosovë.</p> <p>Kompensimi nuk do të paguhet për koston ose vlerën për ndonjë përmirësim të pronës pas datës në të cilën është publikuar vendimi i pranimin të një kërkesë për përpunimin e mëtejshëm të shpronësimit në Gazetën Zyrtare, ose për çdo ndryshim në vlerën e tregut të pronës, pas qoftë datës së miratimit të vendimit që autorizon aktivitetet përgatitore ose datës së paraqitjes fillestare të kërkesës për shpronësim,</p>		

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
Individët dhe grupet e cenueshme	cilado që është në rend e para. Data përfundimtare zbatohet për të drejtat formale ose të drejtat e njohura ligjore në pronë.		
	Nuk ka masa të posaçme në lidhje me grupet e cenueshme.	Duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë grupeve të cenueshme.	Identifikimi i personave të cenueshëm të vlerësuar në këtë PPT. Nuk është identifikuar asnjë person i tillë.
Mekanizmi i ankimit	Pronarët ose zotëruesit e interesave kanë të drejtë të paraqesin ankesa në faza të ndryshme të procesit (gjatë vlerësimit të nevojës për shpronësim dhe ligjshmërinë e procesit dhe gjatë përcaktimit të vlerës së paketës së kompensimit) dhe t'i paraqesin komente me shkrim autoritetit shpronësues gjatë procesit të konsultimit por nuk ka kërkesa për mekanizëm të ankesave specifik për projektin. Nuk njihen procese të konsultimit joformal jashta	Një mekanizëm i ankesave specifik për projektin duhet të krijohet sa më herët që është e mundur në proces, për të marrë dhe trajtuar me kohë shqetësimet specifike në lidhje me kompensimin dhe zhvendosjen që ngrihen nga persona të zhvendosur dhe / ose anëtarë të komuniteteve pritëse.	Procedura e ankimit është ngritur nga Plani i Angazhimit të Palës së Interesit (SEP) dhe është përfshirë në PPT, dhe do të zbatohet nga MI.

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
<p><b>Konsultimet dhe sigurimi i informacioneve</b></p>	<p>mekanizmit të ankesave në dy faza të përshkruar më sipër.</p> <p>Autoriteti Shpronësues bën shpalosjen e informacioneve në vijim: njofton mbajtësin e pronës për kërkesën e paraqitur për shpronësim, publikon Vendimin për miratimin e Kërkesës, mbanë një publik në Komunën ku ndodhen pronat, njofton pronarët e prekur / mbajtësit e interesave për të drejtën e tyre për të parashtruar ankesë në gjykatën kompetente për të kundërshtuar Vendimin, publikon Vendimin Përfundimtar për pranimin ose refuzimin e kërkesës.</p> <p>Nuk ka provizione mbi pronarët që mungojnë nga prona gjatë</p>	<p>Informatat që gjenden në PPT [dhe dokumentet e tjera të shpalosura siç është SEP (plani i angazhimit të palëve të interesit)] duhet të shpalosen publikisht për të siguruar që njerëzit e prekur të kuptojnë procedurat e kompensimit dhe të dinë se çfarë të presin në faza të ndryshme të projektit.</p> <p>Konsultimet me të gjitha PAP-të (palët e prekura të projektit) do të vazhdojnë gjatë gjithë ciklit të jetës së Projektit në përputhje me PPT-në, d.m.th. ato do të ndërmerren gjatë zbatimit të kompensimit dhe monitorimit dhe vlerësimit të pagesës së kompensimit.</p>	<p>Përveç shpalosjes së informacionit të përcaktuar nga legjislacioni kombëtar, NJIP do të sigurojë që PPT-ja të shpaloset publikisht dhe se dhënia e informacionit dhe konsultimet kryhen në përputhje me PPT-n me të gjithë PAP-të pavarësisht nga statusi i formalitetit.</p> <p>Për sa i përket pronarëve të munguar të pronave, MI duhet të angazhohet në mënyrë të qartë për të përdorur përpjekje të dëgjim arsyeshme për identifikimin e duhur dhe gjetjen e çdo pronari të munguar të pronave për të siguruar ofrimin me kohë dhe adekuat të informacionit dhe konsultimet në përputhje me PPT.</p>

Çështja	Dispozitat e Ligjit të Kosovës për shpronësim	Kërkesat e BERZH-it	Masa / Aktiviteti për të plotësuar hendekun
	<p>shpronësim, pra nuk ka masa për të siguruar të drejtat e këtyre pronarëve që të informohen në kohë dhe si duhet për çdo veprim administrativ të ndërmarrë ndaj pronës së tyre dhe për mjetet efektive juridike.</p> <p>Nuk ka provizione mbi shpalosjen e informacionit ose konsultimet me palët e tjera të interesit që nuk janë identifikuar në Kërkesën për Shpronësim (p.sh. përdoruesit joformal)</p>		
Monitorimi i zbatimit të risistemimit/rivendosjes	Nuk ka provizione	Marrëveshjet për monitorimin e rivendosjes duhet të përcaktohen nga plani i rivendosjes.	Monitorimi do të kryhet nga Ministria siç është përcaktuar në PPT.

**Tabela 2: Analiza e hendeqeve që janë relevante për shpronësimin dhe mekanizmat e propozuar për afrues/tejkalues**

### 3. INFORMACIONI BAZË

#### 3.1. REGJISTRIMI I PËRGJITHSHËM

Popullsia e prekur potencialisht dhe parcelat e tokës u identifikuan në bazë të dokumentacionit të disponueshëm të projektit për rehabilitimin e rrugës Kllokot-Gjilan. U përdorën të dhënat kadastrale (të dhënat mbi pronësinë e saktë dhe gjendjen e

përdorimit) nga Elaborati i Shpronësimit. Metodat shitesë të përdorura për grumbullimin e të dhënave për përgatitjen e Regjistrimit të përgjithshëm përfshinin observime në terren dhe ecje tërthore.

Për Regjistrimin, u analizuan pjesët përgjatë rrugës me grumbullimin më të madh të strukturave dhe vëmendje e veçantë i është kushtuar strukturave të pranishme në lokacionet e rrethrotullimeve të planifikuara. Regjistrimi është zhvilluar në mënyrë që të mblidhen dhe të analizohen të dhënat dhe informatat e nevojshme për të identifikuar të gjitha kategoritë e ndikimeve. Baza e të dhënave të Regjistrimit përmban të dhëna për sa vijon:

1. vendndodhjen dhe Komunën Kadastrale,
2. numrin e parcelës së tokës,
3. llojin e parcelës së tokës,
4. llojin e identifikuar të ndikimit,
5. sipërfaqen e përgjithshme të parcelës së tokës (m<sup>2</sup>).

Baza e plotë e të dhënave është në formë të një dokumenti të veçantë në Excel.

Informacioni konfidencial për personat dhe pronat individuale nuk do të shpaloset publikisht nga MI dhe / ose BERZH.

Gjithsej 2 persona u vizituan dhe u intervistuar. Respondentët e intervistuar deklaruan se toka që ata zënë përdoret për aktivitete të biznesit. Sidoqoftë, personat e intervistuar nuk do të preken nga Projekti në kuptim të shpronësimit.

### 3.2. ANKETA SOCIO-EKONOMIKE

Anketa socio-ekonomike është kryer gjatë shtatorit 2017 për të kërkuar mendimet e PAP-ve lidhur me ndikimet e projektit dhe pagesat e kompensimit, si dhe për të marrë të dhëna specifike mbi jetesën aktuale dhe kushtet e jetesës së PAP-ve, duke përfshirë identifikimin e kategorive të cenueshme të PAP-ve.

Anketa është kryer në periudhën 25 shtator 2017 nga një ekip i anketuesve të trajnuar, në bazë të pyetësorëve të anketës të përgatitur nga ekspertë për përvetësim të tokës. Ekipi i gjeodetëve vizitoi pronat e identifikuar.

Për qëllime të Anketës Socio-Ekonomike, është përdorur Pyetësori për bizneset (d.m.th. bizneset që gjenden në parcelën e tokës të prekur nga Projekti).

### 3.3. NDIKIMET E IDENTIFIKUARA

Sipas Elaboratit të Shpronësimit, Projekti do të kërkojë marrjen e pjeshme të tokës prej **11 parcelave të tokës në pronësi private me një sipërfaqe prej 44.452 m<sup>2</sup>**, të ndodhura në Komunitet e Kllokotit, Gjilanit, Parteshit dhe Vitisë. Nuk pritet që do të ndodhë zhvendosja fizike e ekonomive familjare ose bizneseve si pasojë e implementimit të Projektit. Tabela 3 ofron një pasqyrë të ndikimeve të projektit në pronën private në lidhje me përvetësimin e tokës.

**Asnjë përdorues joformal** i tokës nuk pritet të preket nga implementimi i projektit.

Gjithashtu pritet që do të jetë e nevojshme për të zënë përkohësisht një numër parcelash private dhe shtetërore për qëllime të vendosjes së stafit, makinave dhe materialit. Sidoqoftë, në këtë fazë të dizajnit të Projektit, nuk janë definuar lokacionet e sakta të kampeve ndërtimore dhe nuk ka parashikime mbi numrin e parcelave të tokës private që mund të preken në këtë mënyrë.

Ndikimi	Komuna Kadastrale	Numri i parcelave tokësore të prekura/Numri total i parcelave përgjatë karrexhatës	Sipërfaqja e tokës që do të përvetësohet/ Sipërfaqja e përafërt e gjurmës rrugore (m <sup>2</sup> )
Përvetësimi i pjesëshëm i tokës	Gjilan	-/222	-/18630
	Viti	4/160	284/27990
	Partesh	6/227	4160/37080
	Kllokot	1/53	8/15300

**Tabela 3: Përmbledhje e ndikimeve të projektit në lidhje me përvetësimin e tokës sipas Elaboratit të shpronësimit**

Duke mbivendosur të dhënat kadastrale me dizajnin e Projektit, Konsulenti ishte në gjendje të prodhonte ndikimet e pritura në strukturat e pranishme në parcela private të listuara në Elaboratin e Shpronësimit për Komunat e Kllokotit, Parteshit, Vitisë dhe Gjilanit. Ky ushtrim tregoi se **nuk pritet** që parcelat në pronësi private do të preken nga marrja e **strukturës**. Sidoqoftë, përmasa/shkalla e ndikimit në PAP-të formal do të verifikohet gjatë procesit të shpronësimit në përputhje me Ligjin e Shpronësimit, gjatë vlerësimit të pronës dhe ky është vetëm informacion i ndikimit. Informacion i detajuar mbi shkallen e ketyre ndikimeve është perpunuar në seksionin pasues

### 3.4. NJERËZIT DHE PRONAT E PREKURA

#### 3.4.1. Anëtarët e familjes

Asnjë familje nuk do të preket nga shpronësimi i tokës, si rezultat i zbatimit të Projektit.

#### 3.4.2. Përkatësia etnike

Duke pasur parasysh se çështja e kombësisë dhe/ose përkatësisë etnike është një çështje e ndjeshme socio-politike, respondentëve u është dhënë mundësia për t'iu përgjigjur pyetjes në një format të hapur. 100% e respondentëve u deklaruan si shqiptarë.

#### 3.4.3. Prodhimi bujqësor

Asnjë tokë përgjatë seksionit të Projektit nuk përdoret për prodhim bujqësor.

#### 3.4.4. Cenueshmëria

Gjatë regjistrimit nuk janë identifikuar grupe të cenueshme që do të preken nga shpronësimi.



### 3.4.5. Humbjet e perceptuara

Respondentëve iu kërkua të rendisin çdo lloj të mundshëm humbjeje të shkaktuar nga Projekti në një shkallë prej 1-3 sipas rëndësisë së saj, ku 1 nënkupton më të rëndësishmen: humbja e konsumatorëve, pengimi i biznesit për shkak të aktiviteteve ndërtimore, dëmtimi i pajisjeve dhe ndikime të tjera. Një respondent nuk ofroi gradimin e ndikimeve dhe tjetri i konsideron të gjitha të njëjta për nga rëndësia.

### 3.4.6. Preferencat e Kompensimit

Asnjë nga respondentët nuk dha ndonjë përgjigje në lidhje me preferencën e kompensimit dhe as nuk specifikuan ndonjë preferencë ose kërkesë specifike kompensimi.

### 3.4.7. Bizneset

Të dy personat e anketuar përgjatë rrugës së projektit u identifikuan si biznese. Megjithatë, këto nuk do të ndikohen nga shpronësimi i lidhur me Projektin.

## 4. PARIMET KRYESORE TË KOMPENSIMIT, PËRKUFIZIMET DHE ÇËSHTJET

Parimet e mëposhtme të përvetësimit të tokës dhe kompensimit janë marrë përsipër nga Ministria e Infrastrukturës së Kosovës dhe do të respektohen gjatë zbatimit të Projektit:

1. **Përvetësimi i tokës** do të kryhet në përputhje me *Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme në Kosovë*, Politikën Mjedisore dhe Sociale të BERZH-it 2014 dhe Kërkesën e saj të Performancës 5 (*Përvetësimi i Tokës, Risistemimi/rivendosja e Detyrueshme dhe Ekonomike*), këtë PPT dhe praktikën e mira ndërkombëtare. Projekti do të mundësojë marrjen parasysh të mikro rishtrirjeve/riarranzhimeve me qëllim që të shmangët përvetësimi i tokës aty ku është e mundur.
2. **Të gjithë personat e prekur do të njoftohen** dhe konsultohen gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Projektit. Të gjithë pronarët, banorët dhe shfrytëzuesit do të vizitohen dhe do t'iu shpjegohet procesi i përvetësimit të tokës dhe ndikimet specifike në tokën e tyre, ashtu që të mundësohet bërja e mikro-rreshtimeve, në mënyrë që të jepet mundësia për të bërë mikro riarranzhime/rishtrirje për të zvogëluar ndikimet dhe shqetësimet e mundshme.
3. **Vendosje të negociuara do të kryhen** aty ku është e mundur për të ndihmuar në eliminimin e nevojës për të përdorur autoritetin qeveritar për t'i larguar njerëzit me forcë.
4. **Plani i detajuar i Përvetësimit të Tokës (PPT) në përputhje me KP 5** do t'i nënshtrohet konsultimit publik. Çdo informacion/e dhënë mbi pronat dhe personat e prekur në PPT, do të trajtohet si informacion konfidencial dhe nuk do të shpaloset publikisht nga Ministria, ndonjë Komunë dhe/ose BERZH-i.<sup>10</sup> PPT-ja bazohet në informacione të besueshme, të përditësuara dhe përmban informata themelore për Projektin, ndikimet e Projektit, njerëzit e prekur dhe pasuritë (asetet), të drejtat e të gjitha kategorive të njerëzve të prekur si dhe çdo çështje ligjore që lidhen me risistemimin/rivendosjen ose

<sup>10</sup> PPT-ja që përmban informacion/të dhëna konfidenciale do të quhet "vetëm për përdorim të brendshëm" dhe një version i dytë i PPT-së i quajtur "verzion publik" nuk do të përmbajë informacione/të dhëna të tilla.

ndonjë hendeku në mes legjislacionit të Kosovës dhe KP 5. **Anketa bazë/pikënisje socio-ekonomike dhe regjistrimi** për PPT-në kanë identifikuar shfrytëzuesit formalë të tokës/pronës.

5. **Data përfundimtare** për konstatimin e të drejtës/kualifikueshmërisë **për pronarët/përdoruesit formal të tokës** do të jetë **data në të cilën vendimi për pranimin e kërkesës** për procedim të mëtejme të shpronësimit (lëshuar para Vendimit preliminar) publikohet në Gazetën Zyrtare. Personat që janë vendosur në zonën e Projektit pas datës përfundimtare nuk do të kenë të drejtë për çfarëdo kompensimi. Data përfundimtare do të shpalojë dhe shpërndahet publikisht në media dhe takime publike në komunitetet e prekura përkatëse.  
Në përputhje me *Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme*, nga shuma e kompensimit përjashtohen si më poshtë:
  - kostoja ose vlera e çfarëdo përmirësimi që i është bërë pronës, objekteve të ndërtuara ose të zgjeruara në pronë, ose pemëve dhe kulturave të mbjella në pronë pas datës në të cilën vendimi për pranimin e kërkesës për procedim të mëtejme të shpronësimit (lëshuar para Vendimit preliminar) publikohet në Gazetën Zyrtare,
  - çfarëdo ndryshimi në vlerën e tregut të pronës që ndodh ose pas datës së miratimit të vendimit që autorizon aktivitetet përgatitore për atë pronë ose datën e dorëzimit fillestar të kërkesës për shpronësim, cilado që paraqitet më herët,
  - dhe çfarëdo ndryshimi tjetër në vlerën e tregut të pronës para fillimit të procedurës së shpronësimit, nëse dëshmohet se ndryshimet e tilla mund t'i atribuohen manipulimit të çmimit ose manipulimit të tregut ose spekulimit nga personat (ose të afërmit ose bashkëpunëtorët e tyre) të cilët ishin në dijeni të informacionit lidhur me shpronësimin e afërt ose të mundshëm të pronës.
6. **Të gjithë pronarët, banorët apo shfrytëzuesit** e tokës së prekur në kohën e datës përfundimtare, me ose pa të drejta të plota të pranuar të pronësisë, **kualifikohen për kompensim dhe/ose ndihmë**, ashtu siç parashihet në Matricën e të Drejtave (Tabela 24 e këtij dokumenti).
7. **Zënia e përkohshme** e tokës për qëllime të ndërtimit do të kompensohet në përputhje me *Ligjin për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme*, ashtu siç parashihet në Matricën e të Drejtave (Tabela 24 e këtij dokumenti).
8. **Standardi i jetës dhe/ose mjetet e jetesës së njerëzve** të prekur do të rivendoset/restaurohet, e mundësisht edhe të përmirësohet në afat sa më të shkurtër.
9. **Vlerësimi zyrtar i pasurive/përmirësimeve në tokë** do të kryhet nga vlerësues të certifikuar nga Zyra për vlerësim të pronës së patundshme (Departamenti i tatimit në pronë në kuadër të Ministrisë së Financave) apo nga vlerësues të certifikuar të përzgjedhur në bazë të procedurës së prokurimit publik.
10. **Kompensimi** do të ofrohet para përvetësimit të tokës. Çështjet e ndërlidhura me pagesën e kompensimit në mjete monetare, do të diskutohen dhe dakordohen me pronarët dhe të gjithë pjesëtarët e amvisërive të prekura. Kompensimi në mjete monetare do të paguhet në tërësi në llogaritë bankare të përcaktuara nga pronarët, në marrëveshje me të gjithë pjesëtarët e prekur të amvisërive. Në rastet kur ka më shumë se një pronar të pronës, (gjegjësisht, bashkëpronësi nga çiftet e martuar), shumat e

kompensimit do të ndahen dhe do të paguhen në llogari bankare të cilat ata i përcaktojnë.

11. **Personave të prekur nga Projekti dhe komuniteteve do t'iu sigurohen informacione dhe do të konsultohen** në mënyrë që t'iu lehtësohet pjesëmarrja e hershme dhe e informuar në procesin e vendimmarrjes lidhur me përvetësimin e tokës.
12. Do të themelohet një **mekanizëm efektiv i ankimit** për pranimin dhe shqyrtimin e shqetësimeve specifike me kohë, përkritazi me kompensimin dhe zhvendosjen, të ngritura nga personat e zhvendosur.
13. MI-ja do të **monitorojë zbatimin e procesit të përvetësimit të tokës**, si përmes aranzhimeve të brendshme, zyrtare institucionale ashtu edhe përmes një monitoruesi të pavarur, të jashtëm. MI-ja do të inkurajojë institucionet tjera, organizatat ndërkombëtare dhe OSHC-të vendore që të përfshihen në procesin e monitorimit (ju lutem shihni Kapitullin 7.3 për detaje).

## 5. KOMPENSIMI DHE TË DREJTAT

Të gjithë personat që kanë zënë tokën e prekur nga Projekti, të regjistruar në regjistrim kanë të drejtën e kompensimit dhe/ose të restaurimit të mjeteve të jetesës ose ndihmës tjetër siç është përshkruar në Tabelën 4. Niveli dhe lartësia e ndihmës mund të ndryshojnë sipas kategorive të ndryshme të PAP-ëve, sipas ndikimit të identifikuar në Seksionin 3.3 të këtij PPT-je.

Lloji i ndikimit	Kategoria e PAP-ëve	E drejta
<b>HUMBJET E PËRHERSHME</b>		
Humbja e përhershme e strukturave, tokës për ndërtim (duke përfshirë humbjen e qasjes në tokë në pronësi private ose tokë/burime publike).	Pronari i tokës	Kompensimi në mjete monetare me koston e plotë të zëvendësimit  OSE  Zëvendësimi i tokës për ndërtim
	Përdoruesi formal i tokës (qiramarrësi)	Informata për përvetësimin e tokës së paku tre muaj përpara hyrjes në posedim të tokës, për t'i mundësuar qiramarrësit të gjejë tokë tjetër për qira
Humbja e strukturave jo-rezidenciale (gardheve, strehë/hangareve, etj.) dhe infrastrukturës	Pronarët e strukturave dhe infrastrukturës jo-rezidenciale	Kompensimi në mjete monetare me koston e plotë të zëvendësimit  DHE
	(aktivitetit biznesor ose ekonomik)	Kompensimi i zhvendosjes për asetet e luajtshme ose ndihmë për t'i lëvizur ato (nëse kërkohet)
<b>HUMBJET E PËRKOHSHME</b>		
Humbja e përkohshme e tokës për	Pronari i tokës	Kompensimi në mjete monetare me koston e plotë të zëvendësimit për zënieën e

Lloji i ndikimit	Kategoria e PAP-ëve	E drejta
<p><b>ndërtim.</b></p> <p>Për përdoruesit e tokës, kjo i referohet qasjes në tokë në pronësi private ose tokë/burime publike</p>		<p>përkohshme të tokës, në shumën e qirasë sipas çmimit të tregut</p> <p>DHE</p> <p>Restaurimi i tokës dhe infrastrukturës së prekur në kushtet e para-projektit</p> <p>DHE</p> <p>Kompensimi në mjete monetare për çfarëdo humbje/dëmtimi të aseteve (gjegjësisht, strukturat, gardhet, strehë/hangare) me çmim të zëvendësimit</p>
	Përdoruesi formal i tokës (qiramarrës)	Informata për përvetësimin e tokës së paku tre muaj përpara hyrjes në posedim të tokës, për t'i mundësuar qiramarrësit të gjejë tokë tjetër për qira
	Pronari (i aktivitetit biznesor ose ekonomik)	Kompensimi në të holla për të ardhurat neto të humbura (ose të ardhurat e parashikuara dhe/ose humbja e mjeteve të jetesës) gjatë periudhës së çrregullimeve
<p><b>HUMBJA E PËRKOHSHME E TË ARDHURAVE TË BIZNESIT DHE/OSE MJETEVE TË JETESËS (zhvendosja ekonomike) që rezultojnë nga qasja më e vështirë në tokë, ndikimet e telasheve lidhur me ndërtimet (zhurma, pluhuri)</b></p>		
<p><b>HUMBJE TË TJERA TË PAPËRCAKTUARA</b></p>		
Çfarëdo ndikimi i papërcaktuar (humbje e përhershme ose e përkohshme)	Të gjithë PAP-ët	Çdo ndikim i papërcaktuar do të zbutet në përputhje me si Ligjin e Kosovës për Shpronësimin ashtu dhe parimet dhe kërkesat e Politikës së BERZH-it. Në rast të mospërputhjeve në mes të Ligjit mbi Shpronësimin dhe Politikës së BERZH-it në një rast të veçantë, do të mbizotërojë dispozita më e favorshme për pronarin/përdoruesin e prekur

Tabela 4: Matrica e të drejtave

## 6. SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET PUBLIKE

Kërkesat për shpalosje të informatave relevante për Projektin dhe për konsultimet publike, janë paraparë në Planin për përfshirjen e hisedarëve/palëve të interesit (PPH), të përgatitur nga MI-ja, në vitin 2015, me qëllim të përmirësimit të përfshirjes së hisedarëve përgjatë gjithë ciklit jetësor të Projektit, në përputhje me legjislacionin lokal dhe me kërkesat e BERZH-it.

Njësia e Implementimit të Projektit (NJIP) është themeluar për Projektin, që përbëhet nga përfaqësuesit e MI-së, përgjegjës për të siguruar zbatimin e duhur të PPT-së dhe përgjegjës për komunikimin me komunitetet brenda komunave të Kllokotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit dhe konsultimet me PAP-të, si dhe përfaqësuesit e Zyrave Lokale

për Komunitete (ZLK). NJIP-ja, së bashku me përfaqësuesit e komunave të Kllkotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit dhe MMPH (përgjegjës për shpronësimin) janë përgjegjës për komunikimin me komunitetet dhe njerëzit e prekur.

### 6.1. SHPALOSJA E INFORMATAVE DHE KONSULTIMET TË MBAJTURA DERI MË SOT

Gjatë tri viteve të fundit, Komunitet e Kllkotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit dhe MI-ja kanë mbajtur prezantime të Projektit në Komunë. Përfaqësuesit e organizatave joqeveritare lokale (OJQ), pakicat (si popullata rome), mediat dhe aktorët e tjerë u ftuan në këto prezantime. Në korrik të vitit 2016 u mbajt një takim i përbashkët me MI dhe Kryetarët e Komunave të Gjilanit, Kamenicës, Vitisë, Kllkotit, Ranillugut dhe Novobërdës për të diskutuar përmirësimet e infrastrukturës në sektorin rrugor në këtë zonë dhe rëndësinë e mbështetjes së MI-së për komunitetet lokale.

Informata të shkurtra për Projektin u publikuan edhe në mediat lokale dhe në portalet online të lajmeve, si dhe faqet e internetit të MI <sup>11</sup>.

Pakoja e shpalosjes të vigjilencës/kujdesit të duhur për vitin 2015 (PPH, PJT dhe KPT) (SEP, NTS, LAF) është publikuar në faqen e internetit të MI-së në anglisht, shqip dhe serbisht.

Më 16 janar 2018, PPT Rruga Kllkot-Gjilan është shpalosur për publikun në tri gjuhë në faqen e internetit të MI-së dhe të Komunave respektive dhe u azhurnua në tetor 2018. Dëgjimi i parë publik në përputhje me legjislacionin vendor mbi procesin e shpronësimit është realizuar gjatë janarit 2018, përkatësisht më:

- 16 Janar për Komunën e Parteshit (zonat kadastrale: Partesh dhe Budrigë) dhe Gjilan (zonat kadastrale: Gjilan, Livoq i Epërm, Livoq i Ulët dhe Cërnice)
- 17 Janar në Komunën e Vitisë (zonat kadastrale: Budrigë e Epërme dhe Radivojcë) dhe Kllkot (zona kadastrale Kllkot).

NJIP gjithashtu organizoi takimin e konsultimeve publike në përputhje me këtë PPT, më 04.12.2018 në Sallën e Komunës së Kllkotit, mirëpo asnjë pjesëmarrës i jashtëm, PAP etj nuk morën pjesë në takim. Të pranishmit në këtë takim ishin përfaqësues të Komunës së Kllkotit, që është Drejtori i Departamentit të Kadastes, PIU dhe Konsulenti i Mbështetjes së NJIP.

Takimi publik është planifikuar të riorganizohet për shkak të reagimit të dobët të palëve të interesit / PAPve. Takimi publik për tu organizuar gjatë 2019, pas finalizimit të ndryshimeve të projektit bërjes publike të LAP-it të ri, dhe përpara fillimit të punimeve të ndërtimit.

### 6.2. MJETET E KOMUNIKIMIT NË DISPOZICION

MI-ja përdorë kanalet e mëposhtme të përfshirjes së hisedarëve, të komunikimit dhe shpalosjes së informacionit:

- Publikimi i informacionit në faqen zyrtare të internetit të MI-së (<http://mi-ks.net>), e cila është e organizuar mirë dhe përmban informacione relevante kontakti dhe lajme;
- Publikimi i informacionit në tabelat e shpalljeve publike në hapësirat e MI-së;
- Përgjigjja në pyetjet me telefon, postë, faks ose e-mail;
- Shpalljet publike të komunikuar në media (radio lokale /TV, gazeta ditore, etj.) në bazë të nevojave.

### 6.3. SHPALOSJA E PLANIFIKUAR E INFORMACIONIT DHE KONSULTIMET

MI do të kryejë konsultime publike dhe shpërndarjen e informacionit që do të pasqyrojë

---

<sup>11</sup><http://mi-ks.net/sq/lajme/ministria-e-infrastruktures-do-te-realizoj-kater-projekte-rrugore-permes-kredise-nga-berzh-i-1087>

çështjet kryesore që kanë lidhje me Projektin. Të gjithë hisedarët do të informohen me kohë në lidhje me qëllimin e Projektit dhe kontaktet për tu informuar më tej, si dhe disponueshmërinë e dokumenteve që janë në dispozicion të publikut.

### **6.3.1. Dokumentet dhe informacionet që do të shpalosen**

MI-ja ka shpalosur ose synon të shpalosë dokumentet dhe informacionet e mëposhtme në lidhje me Projektin:

- Këtë Plan të Përvetësimit të Tokës (PPT) (shpalosur në janar 2018 dhe përditësuar në tetor 2018 dhe maj 2019);
- Informacion mbi shëndetin e komunitetit dhe rreziqet dhe ndikimet në siguri (duke përfshirë çdo punë ndërtimore, kufizime në qasjen rrugore dhe shqetësime të tjera), masat e propozuara lehtësuese dhe përditësimet lidhur me ecurinë e zbatimit të Projektit;
- Përmbledhje e konkluzioneve nga takimet konsultative dhe diskutimet publike të mbajtura;
- Përmbledhja jo teknike e Vlerësimit Mjedisor dhe Social të Projektit (shpalosur në vitin 2015);
- Plani i përfshirjes së hisedarëve (PPH) (i shpalosur në vitin 2015 dhe që do të përditësohet përpara aktiviteteve të ndërtimit);
- Formulari i Ankimit (shih 0);

Dokumentet do të jenë në dispozicion në gjuhën shqipe dhe serbe (po ashtu edhe anglisht kur janë në dispozicion) menjëherë pas fillimit të Projektit (por të paktën 30 ditë para fillimit të punëve të ndërtimit - periudha që shërben për mbledhjen e vërejtjeve, sugjerimeve dhe propozimeve të publikut) në faqet e internetit të MI-së dhe komunave të Kllokotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit, si dhe në kopje të shtypura në ambientet e MI-së në adresat e mëposhtme:

#### **Ministria e Infrastrukturës**

Adresa: Ndërtesa e Odës Ekonomike, Kati i Parë, Zyra nr. 2, 10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

Këto dokumente dhe informacione do të mbeten në domenin publik për gjithë kohëzgjatjen e ciklit të Projektit.

### **6.3.2. Takimet e planifikuara**

Komuna do të planifikojë dhe do të mbajë takimet e mëposhtme me përfaqësuesit e grupeve të ndryshme të hisedarëve:

- Takimet konsultative publike do të mbahen rregullisht, të paktën çdo 6 muaj, gjatë përgatitjes dhe zbatimit të Projektit, gjegjësisht para dhe gjatë punëve të ndërtimit. Takimi i parë do të mbahet brenda 30 ditëve nga publikimi i PPT-së në faqen e internetit të MI-së, dhe fillimisht u planifikua të mbahej gjatë shkurtit 2018. Takimi i konsultimeve në përputhje me PPT-në u inicua më 04.12.2018 në Sallën e Komunës së Kllokotit, mirëpo asnjë pjesëmarrës i jashtëm, PAP etj nuk morën pjesë në takim, andaj takimi publik është planifikuar të riorganizohet për shkak të reagimit të dobët të palëve të interesit / PAPve. Siç thuhet në Kapitullin 6.1, takimi i dytë publik është për tu organizuar gjatë 2019, pas finalizimit të ndryshimeve të projektit bërjes publike të LAP-it të ri. Të paktën një takim publik do të organizohet para fillimit të punëve të ndërtimit. Takime të tilla do të synojnë mbajtjen e mbledhjeve të rregullta të të gjithë

hisedarëve të interesuar dhe do të jenë të hapura për të gjithë hisedarët e interesuar.

Gjatë këtyre takimeve, pjesëmarrësit do të jenë në gjendje të paraqesin mendimet dhe vërejtjet e tyre në lidhje me Projektin, si dhe të sugjerojnë zgjidhje të mundshme të çështjeve të ngritura, të cilat do të dokumentohen dhe trajtohen në mënyrë të duhur në Raportet e Monitorimit të Implementimit të Projektit në lidhje me ankesat e pranuar dhe veprimet përcjellëse të ndërmarra që duhet të përgatiten nga NJIP-ja. Këto takime do të mbahen në hapësirat e Komunës.

- Takimet konsultative të Komunitetit Lokal kanë për qëllim përfshirjen e individëve, ekonomive familjare dhe bizneseve të prekura nga aktivitetet e ndërtimit në procesin e konsultimit dhe do të organizohen në bazë të nevojave në Komunitetet Lokale.
- Takimet individuale konsultative kanë për qëllim përfshirjen e grupeve individuale të hisedarëve në lidhje me çështje specifike dhe do të organizohen në bazë të nevojave. Ky lloj i takimeve mund të iniciohet nga Komuna, MI-ja ose nga çfarëdo grupi/individ i identifikuar i hisedarëve.

### **6.3.3. Orari i Takimeve Publike**

Orari dhe vendi i caktuar për takimet publike konsultative do të përcaktohet saktësisht nga NJIP pas përcaktimit të datës së fillimit të projektit. Të gjithë hisedarët/palët e interesit do të informohen mbi datën, kohën dhe vendin e saktë ku do të mbahet takimi konsultativ, të paktën 7 ditë përpara, përmes publikimit në faqe të internetit dhe tabela të njoftimit të MI-së dhe Komunës, si dhe në mediat lokale (gazetat, portalet online të lajmeve) sipas nevojës.

Të gjitha informatat dhe dokumentet e disponueshme të Projektit do të vihen në dispozicion të publikut të paktën 7 ditë përpara takimit të parë publik.



**7. IMPLEMENTIMI I PPT-SË****7.1. PËRGJEGJËSITË PËR IMPLEMENTIM**

Të gjitha palët e përfshira në Projekt, duke përfshirë MI, MF (përkatesisht Zyrën e Vlerësimit të Pronës<sup>12</sup>), Komunitetet relevante dhe Kontraktuesit që do të angazhohen nga MI për të punuar në lokacionet e Projektit, duhet të zbatojnë dispozitat e këtij PPT-je. Përgjegjësitë do të ndahen ndërmjet MI-së, MMPH-së, MF-së, Komunave të Kllokotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit, Kontraktuesit dhe agjencive të tjera, sipas Tabelës 5. NjIP-ja e themeluar brenda MI-së do të sigurojë zbatimin e duhur të PPT-së dhe do të jetë përgjegjëse për komunikimin me komunitetet dhe konsultimet me PAP (njerëzit e prekur nga projekti), si dhe përfaqësuesit e Zyrave Lokale të Komuniteteve (ZLK).

Detyra	Autoriteti Përgjegjës
Shpalosja e informatave për të gjithë njerëzit e prekur nga Projekti dhe komunitetet	MI përmes NjIP dhe Komunitet e Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit
Vlerësimi i pronës	MF (Zyra për Vlerësimin të Pronës)
Komunikimi direkt dhe vizitat pronarëve/banuesve	MI si përfitues i shpronësimit dhe MMPH si autoritet shpronësues
Negociatat dhe aktivitetet e shpronësimit, para fillimit të ndërtimit	MMPH
Pagesa/ofrimi i pakove të kompensimit	MMPH
Monitorimi dhe raportimi në lidhje me shpronësimin	MI përmes NjIP
Monitorimi dhe raportimi përkitazi me shfrytëzimin e përkohshëm të tokës kryer pas fillimit të ndërtimit	Kontraktuesi
Menaxhimi i ankimeve	MI përmes NjIP dhe Kontraktuesi

**Tabela 5: Përgjegjësitë e Implementimit të PPT-së**

Më poshtë janë paraqitur hapat e ardhshëm në zbatimin e këtij PPT-je:

1. Shpalosja e PPT-së (dhe informacione tjera relevante të Projektit, siç është përshkruar në Seksionin 6.3.1. të këtij PPT) në faqen e internetit të MI dhe faqen e internetit të Komunave të Kllokotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit pas miratimit nga BERZH. Ofrimi i kopjeve fizike të PPT-së në ambientet e MI-së dhe të Komunave të Kllokotit, Vitisë, Parteshit dhe Gjilanit në rast të kërkesës së palëve të interesuara;

<sup>12</sup> Zyra për vlerësim të pronës së paluajtshme (në kuadër të Departamentit për tatimin në pronë) përbrenda Ministrisë së Financave, organ i vetëm publik ky i cili është kompetent për vlerësimin e patundshmërive që do t'i nënshtrohen shpronësimit.

2. Ngritja e Regjistrat të Ankesave dhe shpaloja e Formularit të Ankesave në faqen e internetit të MI-së dhe ofrimi i ndihmës për të gjithë personat e interesuar siç është përshkruar në Kapitullin 8. të këtij PPT- je;
3. Organizimi i takimeve me akterët siç është përshkruar në Seksionet 6.3.2. dhe 6.3.3. të këtij PPT-je dhe vizitat individuale te personat e prekur në mënyrë të drejtpërdrejtë ashtu siç është përshkruar në Seksionin 6.3.2 të këtij PPT-je.
4. Vlerësimi i pronës, negociatat dhe aktivitetet e shpronësimit në përputhje me legjislacionin kombëtar (nga Organi për Shpronësim) siç përcaktohet në Seksionin 1.3.2. të këtij PPT-je;
5. Ngritja dhe mbajtja e një baze të dhënash për përvetësimin e tokës dhe monitorimi i procesit të përvetësimit të tokës siç përshkruhet në Seksionin 7.3 të këtij PPT-je dhe raportimi në BERZH;
6. Zhvillimi i Auditimit të Përfundimit në fund të procesit të përvetësimit të tokës dhe raportimi në BERZH.

## 7.2. KOSTOT

Kostot e përvetësimit të tokës barten nga MMPH si autoritet i shpronësimit. Buxheti për përvetësimin e tokës do të përgatitet pasi që Kërkesa për Shpronësim të procedohet nga MMPH, MF dhe Qeveria e Kosovës dhe kostot e përafërta të përcaktohen në përputhje me Ligjin e Kosovës për Shpronësim.

## 7.3. MONITORIMI DHE RAPORTIMI

Monitorimi i procesit të përvetësimit të tokës do të bëhet nga NJIP e ngritur brenda MI-së në mënyrë që:

- të konstatojë nëse aktivitetet janë duke u zhvilluar sipas orarit dhe afatet kohore janë duke u përmbushur;
- të sigurojë që standardet e jetesës së PAP (NjPP) të rivendosen/restaurohen ose përmirësohen;
- të vlerësojë nëse masat e kompensimit janë të mjaftueshme;
- të identifikojë problemet/çështjet potenciale; dhe
- identifikojë metodat për të zbutur çdo problem të identifikuar.

NJIP do të mbajë një bazë të dhënash për përvetësimin e tokës mbi familjet/bizneset pronat e të cilave janë prekur (duke përfshirë edhe jo pronarët). Të dhënat/informacioni do të përditësohen periodikisht në mënyrë që të mbahet evidenca e progresit të familjeve dhe bizneseve.

Treguesit që do të përdoren për monitorimin do të përfshijnë në veçanti si vijon:

- Shpenzimet e përgjithshme për shpronësim dhe kompensim
- Numri i Njerëzve të Prekur nga Projekti dhe numrit të familjeve të prekura nga projekti sipas kategorive
- Numri i takimeve publike dhe konsultimeve me njerëzit e prekur
- Numri dhe përqindja e marrëveshjeve individuale të kompensimit të nënshkuara para fillimit të aktiviteteve ndërtimore
- Numri i personave që kërkojnë asistencë të veçantë dhe llojet e asistencës që u ofrohen individëve/familjeve të cënueshme në kohën e duhur
- Numri i personave që kanë pranuar kompensim në të holla gjatë periudhës së monitorimit me shpërndarjen sipas llojit të kompensimit dhe sipas klasave të shumave
- Numri dhe shuma e pagesave për të rikthyer humbjen e të ardhurave

- Numri dhe lloji i ankimeve, përfshirë çdo rast gjyqësor, lidhur me përvetësimin e tokës (parashtruar dhe zgjidhur dhe sa kohë është dashur për zgjidhjen e tyre). NJIP do të përgatisë dhe do t'i paraqesë BERZH-it Raportin Vjetor Mjedisor dhe Social (AESR) duke përfshirë progresin e arritur në zbatimin e PPT-së. Përveç kësaj, NJIP do të lehtësojë zhvillimin e një Auditimi të Përfundimit nga një ekspert i pavarur në fund të procesit të përvetësimit të tokës. Raporti i auditimit do të vlerësojë nëse janë arritur objektivat e PPT-së dhe do të identifikojnë çdo veprim përmirësues nëse është e nevojshme. Raporti i auditimit do të ndahet me BERZH.

## 8. MEKANIZMI I ANKESAVE

NJIP do të krijojë një Regjistër të Ankesave dhe do të sigurojë që të gjithë akterët të jenë plotësisht të informuar lidhur me mekanizmin e ankesave duke komunikuar disponueshmërinë e këtij regjistri, funksionin e tij, personat e kontaktit dhe procedurat për paraqitjen e një ankesë në zonat e prekura.

Çdo koment ose shqetësim mund t'i parashtrohet NJIP-së ose Kontraktorit verbalisht (personalisht ose me telefon) ose me shkrim duke mbushur formularin e ankesës (shih 1) (duke e dorëzuar atë personalisht, me postë, faks ose me e-mail për adresën/numrin e dhënë më poshtë), pa asnjë kosto për ankuesin. Ankesat gjithashtu mund të dorëzohen në mënyrë anonime.

Të gjitha ankesat do të regjistrohen në Regjistrin e Ankesave dhe do t'u caktohet një numër, dhe do të vërtetohen brenda 5 ditëve kalendrike (grafiku i rrjedhës për procedimin e ankesave është dhënë në 0). Regjistri do të ketë të gjitha elementet e nevojshme për zbërthimin e ankesës sipas gjinisë së personit që e regjistron atë, si dhe sipas llojit të ankesës. Secila ankesë do të regjistrohet në regjistër me informacionin e mëposhtëm:

- përshkrimin e ankimit/ankesës,
- datën e vërtetimit të pranimit i cili i kthehet parashtruesit të ankesës,
- përshkrimin e veprimeve të ndërmarra (hetimet, masa korigjuese), dhe
- data e zgjidhjes dhe mbylljes/dhënia e reagimeve parashtruesit të ankesave.

Nëse ankesa është e paqartë, NJIP do të ofrojë ndihmë dhe do të sigurojë këshillim për formulimin/rihartimin e parashtruesës, në mënyrë që ankesat të bëhen të qarta, për qëllime të një vendimi të informuar nga PIU në të mirën e personave të prekur nga Projekti.

NJIP do të bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të adresuar ankesën pas vërtetimit të ankimit/ankesës. Nëse NJIP nuk është në gjendje të trajtojë çështjen e parashtruar me veprime të menjëhershme korigjuese, do të identifikohen veprimi afatgjatë korigjues. Parashtruesi i kërkesës njoftohet lidhur me masën e propozuar korigjuese dhe masat pasuese korigjuese në afat prej 25 ditëve kalendrike për vërtetimit të pranimit të ankesës. Nëse NJIP nuk është në gjendje të trajtojë një çështje të caktuar të ngritur përmes mekanizmit të ankesave apo nëse veprimi nuk është i nevojshëm, ajo jep sqarime/arsyetime të hollësishme lidhur me atë se pse çështja nuk është trajtuar. Përgjigja gjithashtu do të përmbajë një shpjegim se si personi/organizata e cila e ka parashtruar ankesën mund të vazhdojnë tutje në procedurë ankimi nëse rezultati nuk është i kënaqshëm.

Gjatë gjithë kohës, parashtruesi i ankesës mund të kërkojë mjete të tjera ligjore në përputhje me kornizën ligjore të Kosovës, duke përfshirë edhe ankesë formale gjyqësore.

Për punëtorët ekziston mekanizëm i veçantë i ankesave/ankimit.

**Informatat kontaktuese për pyetje dhe ankesa:**

Për: Kreu i NJIP – z. Qamil Feka,

Ministria e Infrastrukturës

Adresa: Ndërtesa e Odës Ekonomike, Kati i Parë, Zyra nr. 2, 10000,

Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail 1: mi.info@rks-gov.net

E-mail 2: Qamil.Feka@rks-gov.net

E-Mail 3: Valdete.a.mustafa@rks-gov.net

Tel.: +381 (0) 38 200 28 610

**Informatat kontaktuese për pyetje:**

Zyra për informim publik brenda Ministrisë së infrastrukturës

Tel/fax.: +381 (0)38 200 28 lok. 507

Tel/fax.: +381 (0)38 200 28 lok. 041

Tel/fax.: +381 (0)38 200 28 lok. 048

**Shtojca 1-Kërkesa për Shpronësim (përkthim kurtoazie)**

**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS**  
**DEPARTAMENTI I INFRASTRUKTURËS**  
**RRUGORE**  
**LISTË DISTRIBUIMI (ROUTING SLIP)**

	22/06/2017
Referenca	5197/2017
Për:	Arben Citaku-Sekretar i Përgjithshëm/MMPH Afrim Murati-Drejtor i Departamentit të Shpronësimit/MMPH
CC:	
Përmes:	Nebih Shatri- Sekretar i Përgjithshëm/(U.D) Rame Qupeva - Drejtor i Departamentit të Infrastrukturës Rrugore
Nga:	Hysen Merovci- Menaxher i shërbimeve gjeodezike
Tema:	Inicimi i procedurave të procedurës së shpronësimit për projektin: "Rehabilitimi i rrugës nacionale N25.3, Seksioni: Kllokot - Gjilan", L = 14.5km

I nderuar z. Çitaku,

Për procedurat në vijim, ju mund të gjeni të bashkangjitur në letër dorëzimin:

- Anketa e shpronësimit për: "Rehabilitimi i rrugës nacionale N25.3, Seksioni: Kllokot - Gjilan", L = 14.5km

Ne kërkojmë që ju të procedoni më tej me parcelat e bashkangjitura në këtë anketë, me procedurat e mëposhtme bazuar në Ligjin për Shpronësimin e Pronave të Paluajtshme, për vlerësim në Ministrinë e Financave.

Bashkangjitur në këtë letër dorëzimi mund të gjeni anketën me zonat kadastrale të specifikuar për këtë seksion të rrugës, 3 kopje të shtypura dhe CD.

Faleminderit për bashkëpunimin tuaj!

**Shtojca 2 Formulari i Ankesave**

Numri referues:	
Emri i plotë (fakultativ)	
Informatat për kontakt Ju lutemi shënoni se si dëshironi të kontaktoheni (postë, telefon, e-mail)	Me Postë (Ju lutem shënoni adresën postare): _____ _____ Përmes Telefonit: _____ Përmes Email-it: _____
Gjuha e parapëlqyer e komunikimit	Shqip Serbisht Anglisht (nëse është e mundur)
Përshkrimi i incidentit për ankesë	Çfarë ndodhi? Ku ndodhi? Kujt i ndodhi? Cili është rezultati i problemit?
Data e incidentit/ankesës	
	Incident / ankesë njëherëshe (data _____) Ka ndodhur më shumë se një herë (sa herë? _____) Në vazhdim e sipër (aktualisht e vuaj problemin)
Çka do të donit të bëhej?	

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_  
Data: \_\_\_\_\_

Ju lutemi ktheni këtë formular tek:  
**NJËSIA PËR ZBATIM TË PROJEKTIT – MINISTRIA PËR INFRASTRUKTURË**

Për: Z. Qamil Feka

Adresa: Ndërtesa e Odës Ekonomike, Kati i Parë, Zyra nr. 2,  
10000, Prishtinë, Republika e Kosovës

E-mail 1: mi.info@rks-gov.net

E-mail 2: Qamil.Feka@rks-gov.net

E-mail 3: Valdete.a.mustafa@rks-gov.net

Tel.: +381 (0) 38 200 28 610

**Shtojca 3 Grafiku i rrjedhës për procesimin e ankesave**

